



# Kuadri ligjor per certifikimin dhe tregtimin e produkteve Bio ne funksion te zhvillimit te qendrueshem dhe te mbrojtjes se mjedisit

(Resource ID: 351)

## Andon Kume

andon.kume(at)gmail.com

This teaching resource is allocated to following University:

**UAMD - Aleksandër Moisiu University of Durrës**

Institution:

**UAMD**

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/351.Kuadri-ligjor-per-certifikimin-dhe-tregtimin-e-produkteve-Bio-ne-funksion-te-zhvillimit-te-qendrueshem-dhe-te-mbrojtjes-se-mjedisit>



Puna ne grup



Me pak sesa 5  
studente



Deri në 3 njësi  
leksionesh



Anglisht, Shqip

Shqiperia shquhet per nje larmi te larte biologjike, por keto 20 vitet e fundit ajo ka vuajtuar dhe po vuan nga nje erosion i paperballueshem me efekte shkaterrimtare ne mjedis. Nje nga menyrat per te ndaluar kete erosion eshte implementimi sa me i gjere i sistemit te bujqësisë organike. Ky sistem mbështet ekuilibrin natyror të prodhimit, duke zbatuar metodat natyrore të mbrojtjes, si dhe përdorimin e plotë të burimeve natyrore dhe të atyre ripërtëritëse. Si l tille ky sistem ndihmon ne menyre thelbesore ne

ruajtjen e mjedisit. Implementimi i nje sistemi te tille kerkon njohjen e legjislacionit dhe rregullave te prodhimit certifikimit dhe tregtimit te ketyre produkteve.

Materiali mesimos ka per qellim njohjen e studenteve me ceshtje qe kane te bejne me legjislacionin dhe rregullat per certifikimin dhe marketimin e produkteve Bio si dhe rendesine e tyre ne funksion te zhvillimit te qendrueshem dhe mbrojtjes se mjedisit.

Bujqesia eshte nje sektor shume i rendesishem i ekonomise. Sistemi i bujqesise organike nuk eshte tashme nje koncept i ri dhe ai synon kultivimin e e rritjen e bimeve, por me kushtin qe te ruhet pjelloria e tokes dhe mikroorganizmat e gjalle te saj, duke perdorur mbetjet organike bimore, shtazore dhe mbeturinat e tjera te fermes, me qellim qe te siguroje ushqim per bimet dhe prodhim te qendrueshem ne nje mjedis ekologjik jo te ndotur. Bujqesia organike ofron perfitime me interes per shendetin dhe per mbrojtjen e mjedisit. Tashme eshte e vertetuar se ajo ka edhe ndikim pozitiv mbi ekonomite fshatare si nga pikpamja e krijimit te te ardhurave, ashtu dhe ajo e larmise se veprimtarive ekonomike.

Ky material mesimor fillimisht do ti prezantohet studenteve te kursit e drejte mjedisi te programit Bachelor ose Master ne Drejtesi, duke filluar me nje diskutim te hapur mbi strumentat qe mund te perdoren per mbrojtjen e mjedisit ne pergjithesi dhe rolin e prodhimeve Bio ne vecanti.

Me pas studentet do te marrin pjese ne nje leksion te hapur ku do te ligjerojne nje perfaqesues i Shoqates "BIO ADRIA" dhe nje fermer i zones se Durresit qe prodhon rrush bio. Ky leksion do te kete per qellim familjarizimin e studenteve me rolin qe mund te luajne fermat Bio ne mbrojtjen e ambientit dhe ne zhvillimin rural te qendrueshem nepermjet prezantimit te rasteve praktike te fermave Bio si dhe literatures boterore ne kete fushe.

Me pas studentet do te njihen me legjislacionin shqiptar per prodhimin, certifikimin dhe marketimin e produkteve Bio si dhe rregullat per perfitimin e subvencioneve nga ana e shtetit.

Hapi i radhes do te jete formimi i grupeve te studenteve (4-5) te cileve do tu jepet nje produkt dhe ata do te duhet te perpunojne nje dokument qe do te permbaje instruksionet kryesore per prodhimin e ketij produkti ne menyre organike si dhe cdo dokument tjeter te nevojshem per certifikimin, marketimin dhe perfitimin e subvencioneve shteterore.

---

## Mjetet e mësimdhënies



Mini-projekt për studentët Case study Material i shkruar

## Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Aktoret që do të jenë drejteperdrejte të përfshira në këtë material mesimor do të jenë: Shoqata "BIO ADRIA", komuniteti i fermerëve të zonës së Durrësit.

### Pika e forte

- Trajton një problem të rëndësishëm siç është ai i ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit rural të qëndrueshëm.
- E mundëson nxënësin që të mendojnë për një problem dhe më pas të përpunojë mënyra të ndryshme për zgjidhjen e tij.
- I jep studentit idenë themelore të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural përmes mbështetjes së prodhimit dhe marketingut të produkteve BIO.

### Pika e dobët

- Mungesa e vetëdijes për rolin e BIO Bujqësisë në mbrojtjen e mjedisit dhe përfitimet e saj ekonomike.

## Rezultatet e të mësuarit

Objektivat e këtij materiali mesimor janë:

1. Ndergjegjësimi i studentëve me problematikat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit rural të qëndrueshëm
2. Përgatitja e studentëve në punën në grup dhe në fusha ndërdisiplinore si kusht i domosdoshëm për të pasur sukses në karrierën e tyre.
3. Përgatitja e studentëve me ekspertizën e nevojshme në një fushë që aktualisht në Shqipëri nuk është shumë e rrahur

## Lidhja për qëndrueshmëri

- Nxënësit mendojnë për mbrojtjen e mjedisit dhe sfidat e saj
- Studentët do të fillojnë të njihen me rolin efektiv të ligjit mjedisor dhe ndërlidhjet e shumta të tij me disiplina të tjera të tilla si ligji për sistemet e

prodhimeve bio

## Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

## Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

## Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

- Përgatitja teorike mbi rëndësinë e produkteve BIO. (2 orë) - Leksion i hapur teorik mbi aspektet ligjore për certifikimin, marketimin dhe subvencionimin e produkteve Bio (3 orë) - Përgatitja e një dokumenti që përmban instruksionet kryesore për prodhimin e një produkti Bio dhe certifikimin, marketimin dhe përfitimin e subvencioneve, nga grupet e punës. (20 orë)

## Aksesi

Free

## Gjykimi / vlerësimi

-

## Kreditim/Çertifikatë

-

## Burime dhe lidhje

-

## Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.